

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **K.K. SKENDERAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	643-26-3911-2-1-1
Nr i brendshëm	011

Sa i përket tenderit për: “011 - Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit brenda territorit të Komunës së Skenderajt”.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

AS TERMO SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Edi Durhan p.n.

(Adresa)

Skenderaj

(Vendi)

41000

(Kodi postar)

049137402

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Arnold Sylja

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

astermoshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

10.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Data e njoftimit për kontratë: 22.05.2026 Data e planifikuar e hapjes së ofertave: 11.08.2026 në ora 11:00 Kërkesës për Rishqyrtim e dt.04.08.2026 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:05.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

--

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po



Jo



Bashkangjitur keni vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 51 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 17 i RRPP Nr.001/2022
Neni 25 i RRPP Nr.001/2022.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Data e njoftimit për kontratë: 22.05.2026, kurse data e planifikuar e hapjes së ofertave ka qenë e parashikuar të bëhet me 19.06.2026 në ora 14:00.

Fillimisht duhet sqaruar faktin se për këtë aktivitet të prokurimit ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe pastaj ankesën në OSHP. Në lidhje me ankesën tonë është nxjerr një vendim nga OSHP-ja ku është aprovuar pjesërisht ankesa jonë dhe AK-ja është detyruar të bëjë ndryshimet e dosjes së tenderit.

Pas vendimit të OSHP-së AK-ja ka publikuar përsëri dosjen e tenderit, por nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së në tërësi, prandaj ne jemi të detyruar të parashetrojmë ankesën më pretendimet si më poshtë:

Në dosje të tenderit është kërkuar “Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 200.000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare ose depozite) ose të paktën 200.000 euro qasje për kredi në dispozicion. Në rast të konzorciumit kjo shumë të mbulohet nga Lideri 51% e vlerës”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Dëshmia 2. Deklarata nga banka që vërteton disponueshmërinë e 200.000 euro në llogarinë bankare të kompanisë (për shembull në

llogarinë bankare ose depozite) apo një vërtetim bankar (shënim premtues te pa kushtezuar) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi prej 200.000 EUR, nëse është e nevojshme për realizimin e këtij projekti. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë. Original me vulë nga banka”.

Konsiderojmë se kjo kërkesë është joproporcionale, diskriminuese dhe nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Objekti i këtij aktiviteti të prokurimit është kontratë shërbimi dhe jo kontratë pune apo projekt investiv që kërkon angazhim të konsiderueshëm kapitali paraprak nga operatori ekonomik. Për më tepër, autoriteti kontraktues e ka përcaktuar që kontrata për këtë aktivitet të prokurimit të jetë me çmime njësi, fakt ky që nënkupton se pagesat realizohen sipas shërbimeve të kryera dhe sasive të realizuara, ndërsa vetë autoriteti kontraktues nuk ka përcaktuar paraprakisht sasinë e saktë të shërbimeve që do të kontraktohen.

Autoriteti Kontraktues në asnjë mënyrë nuk mund të jep ndonjë arsyetim se përse realizimi i kësaj kontrate kërkon që operatorët ekonomikë të disponojnë mjete në llogari prej 200,000.00 € apo të kenë qasje në kredi të pakushtëzuar në të njëjtën vlerë. Për më tepër, posedimi i mjeteve të gatshme në llogari bankare apo qasje në kredi të pakushtëzuar nuk përbën dëshmi që vërteton realizimin e kontratës, prandaj një kërkesë e tillë është kufizim i panevojshëm që favorizon vetëm operatorë të caktuar ekonomik, të cilët posedojnë mjetet në llogari apo qasjen në kredi të pakushtëzuar.

Një kërkesë e tillë favorizon operatorë të caktuar ekonomikë që disponojnë mjete të konsiderueshme financiare ose linja krediti, duke kufizuar pa nevojë konkurrencën dhe duke penguar pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomikë të cilët posedojnë kapacitetet profesionale dhe teknike për realizimin e kontratës, por që nuk mbajnë mjetet e kërkuara të bllokuara në llogari bankare.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor, AK-ja në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është arsyetuar se vendosja e kërkesës për 200,000.00 € mjete likuide ose qasje në kredi të pakushtëzuar është në diskrecionin e autoritetit kontraktues dhe se kjo kërkesë është përcaktuar në përputhje me dispozitat ligjore. Gjithashtu, autoriteti kontraktues i referohet vendimit të OSHP-së nr. 2026/0415, duke theksuar se Paneli Shqyrtues e ka konsideruar këtë çështje si pjesë të diskrecionit të tij.

Sqarojmë se, pretendimi ynë nuk ka të bëjë me mohimin e të drejtës së autoritetit kontraktues për të përcaktuar kritere lidhur me kapacitetin ekonomik dhe financiar, por me mungesën e arsytimit konkret dhe proporcional për përcaktimin e shumës prej 200,000.00 €. Vetë vendimi i OSHP-së nr. 2026/0415 ka konstatuar se lidhur me këtë kërkesë duhet të merret parasysh konstatimi i ekspertit shqyrtues dhe se autoriteti kontraktues duhet të arsyetojë vendosjen e këtij kriteri.

Në këtë drejtim, autoriteti kontraktues nuk ka sqaruar pse është përcaktuar pikërisht shuma prej 200,000.00 €, nga është nxjerrë kjo vlerë dhe cilat janë nevojat konkrete të kontratës që e justifikojnë një kërkesë të tillë. Vetëm referimi në diskrecionin e autoritetit kontraktues nuk përbën arsyetim për proporcionalitetin e kësaj kërkesë.

Prandaj, konsiderojmë se autoriteti kontraktues nuk e ka adresuar pretendimin tonë, por vetëm ka përsëritur të drejtën e tij për përcaktimin e kritereve. Pikërisht çështja e kontestuar nga ne është nëse kjo kërkesë konkrete prej 200,000.00 € është e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, për të cilën autoriteti kontraktues nuk ka dhënë ndonjë arsyetim të mjaftueshëm.

Andaj, kërkojmë që të largohet kërkesa e lartcekur nga dosja e tenderit, pasi që e njëjta është e panevojshme, joproporcionale dhe kufizuese për OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht e njëjta favorizon OE të cilët posedojnë mjetet e kërkuara në llogari, e të cilat siç e cekëm janë të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional po ashtu është kërkuar “Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Dëshmi 4. mbi pronësinë (apo marrëveshje të marrjes me qira) të mjeteve, librezat e qarkullimit ndërsa për ato mjete që nuk kanë librezat të qarkullimit. d Deklaratat unike doganore. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Vëmendje poz. 2, 8 deri 13 duhet te prezantohen me librezat valide te regjistrimit! Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët”.

Kur analizohet Aneksi 7 i dosjes së tenderit, vërehet qartë se një pjesë e pajisjeve të kërkuara nuk janë në përputhje me natyrën e shërbimeve që janë objekt i këtij aktiviteti të prokurimit, rrjedhimisht të njëjtat janë të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Tek Aneksi 7 i Dosjes së Tenderit, AK-ja ka kërkuar pajisjet si në vijim:

AK-ja ka kërkuar: 2 (dy) makina ngjeshëse vibruese max. 1 ton;

Kjo kërkesë është e panevojshme pasi që nga analiza e paramasës shihet qartë se nuk është e nevojshme posedimi i dy makinave të lartcekura me tonazhen e kërkuar. Një ngjeshëse e tillë është e panevojshme, prandaj kërkojmë që të ndryshohet kërkesa e lartcekur duke e kërkuar vetëm një makinë ngjeshëse, pasi që një e tillë është e mjaftueshme, për këtë aktivitet të prokurimit.

Është kërkuar: Kamion kiper me vinç dhe korpë me kapacitet minimal 7 ton, me atest;

Kërkesa e lartcekur që të prezantohet kamioni me a test është kërkesë e panevojshme dhe e njëjta favorizon OE të caktuar të cilët posedojnë kamionin me test. Kërkojmë që a testi i kërkuar të largohet në tërësi nga dosja e tenderit, pasi që siç e cekëm e njëjta është kërkesë diskriminuese dhe favorizon OE të caktuar. Njëkohësisht edhe kapaciteti i kërkuar prej min.7 ton, është i panevojshëm dhe nuk përkon me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, prandaj kërkojmë që të ndryshohet kërkesa e lartcekur duke e ulur kapacitetin minimal në 2 ton, me qëllim që të hapet konkurrenca dhe të mos diskriminohet OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit.

Është kërkuar: Damper min.5 ton;

Kjo pajisje është e panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit sepse e njëjta nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me shërbimet e parapara në këtë aktivitet të prokurimit. Pra kërkesa e lartcekur në lidhje me damperin është kërkesë kufizuese dhe jo proporcionale për këtë aktivitet të prokurimit dhe e njëjta favorizon OE të caktuar, prandaj kërkojmë që e njëjta të largohet në tërësi nga dosja e këtij aktiviteti të prokurimit.

Është kërkuar: Cisternë autobot uji me kapacitet minimal 15 ton, me atest;

Kërkesa për pajisjen e lartcekur, në momentin që analizohet paramasa e këtij aktiviteti të prokurimit, atëherë shumë qartë do të kuptohet se e njëjta është e panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, pra nuk është në harmoni me paramasën e këtij aktiviteti. Gjithashtu edhe atesti i kërkuar për pajisjen e lartcekur përbën kërkesë shtesë dhe të panevojshme për këtë aktivitet të prokurimit, prandaj kërkojmë që të largohet në tërësi nga dosja e tenderit.

Duhet cekur fakti se tek autoboti i kërkuar prej min.15 ton, shumica e punimeve për këtë aktivitet të prokurimit do të kryhen në qytet dhe vendet përcjellëse ku kjo cisternë as nuk ka qasje dhe është krejtësisht e panevojshme dhe e paarsyeshme të specifikohet kufizimi i peshës min.15 ton. Prandaj kërkojmë që të largohet pesha e përcaktuar nga AK-ja me qëllim të hapjes së konkurrencës dhe të mos favorizohen OE të caktuar.

Nëse autoriteti kontraktues e konsideron se duhet të prezantohet cisterna e kërkuar, atëherë kërkojmë që të largohet kërkesa që e njëjta të posedoj atest, pasi që një kërkesë e tillë, favorizon OE të caktuar të cilët posedojnë cisternën me atestin e kërkuar, ndërsa diskriminohen OE të cilët nuk posedojnë një dokument të tillë, i cili është i panevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

AK-ja ka kërkuar: **Makineri hidraulike per ngjeshje qe montohet ne eskavator min. 450-600 kg;** Kufizimi i peshës së pajisjes së lartcekur është shumë specifik, i panevojshëm dhe nuk ndikon në funksionin e pajisjes. Siç e dijmë pajisja montohet në ekskavator dhe mund të funksionojë me karakteristika ekuivalente, pa peshë të caktuar. Prandaj kërkojmë që të largohet në tërësi kërkesa në lidhje me peshën dhe të lejohet të ofertohej me pajisjen e lartcekur me çfarëdo tonazhe.

Kërkesa e lartcekur kufizon operatorët që posedojnë pajisje me karakteristika të ngjashme dhe funksion të njëjtë, ndërsa favorizon OE të cilët posedojnë pajisjen e lartcekur me tonazhën e kërkuar. Kërkojmë të sqarohet se cila dispozitë ligjore, standard teknik apo kërkesë profesionale përcakton se dheu në punimet e gypave të kanalizimit duhet të ngjeshet me pajisje të kësaj peshe.

Nëse një kërkesë e tillë nuk ekziston, nuk ka bazë të arsyeshme për kufizimin e pajisjes në 450–600 kg, andaj kërkesa duhet të largohet dhe të lejohen pajisje ekuivalente që përmbushin funksionin e njëjtë. Moslargimi i këtij kufizimi, pa ofruar ndonjë arsytim teknik apo bazë normative, cenon konkurrencën dhe mund të favorizojë operatorë ekonomikë të caktuar. Për këtë arsye, kërkojmë nga OSHP-ja që ta shqyrtojë këtë kërkesë dhe të urdhërojë korrigjimin e specifikimit teknik.

AK-ja ka kërkuar: **Gjysemrimorkio kompresore deri 850 kg;**

Kërkesa për kufizimin e peshës deri në 850 kg është e panevojshme dhe kufizon konkurrencën, pasi që cila është arsyeja e kufizimit të peshës deri në 850 kg, kur performanca dhe kapaciteti i kompresorit përcaktohen kryesisht përmes fuqisë së tij në kW dhe parametrave teknikë të punës, e jo përmes peshës në kg. Ky kufizim, pa ndonjë arsytim të qartë teknik, përjashton produkte të përshtatshme nga prodhues të ndryshëm dhe zvogëlon konkurrencën. Përpos arsyes së përshtatshmërisë dhe zvogëlimit të konkurrencës, kërkojmë që kufizimi i peshës deri në 850 kg të hiqet.

Për këto arsye, kërkojmë që këto kërkesa të rishikohen dhe të largohen ato që nuk janë të domosdoshme për realizimin e kontratës, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca dhe të sigurohet trajtim i barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Po ashtu duhet sqaruar fakti se në disa prej pajisjeve të kërkuara në Aneksin 7 është vendosur kushti që ato të jenë të pajisura me “atest”. Ky kusht nuk ndikon në funksionimin apo kapacitetin teknik të pajisjeve për realizimin e shërbimeve të parapara në kontratë, dhe nuk sjell ndonjë vlerë shtesë në aspektin e ekzekutimit të punëve. Gjithashtu, ky kusht është aplikuar vetëm për disa pajisje dhe jo për të gjitha, pa një trajtim të njëjtë dhe të arsyetuar.

Prandaj edhe një herë kërkojmë që kushti për atest të hiqet, ose të aplikohet në mënyrë të njëjtë për të gjitha pajisjet e kërkuara në Aneksin 7.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e lartcekura kuptohet qartë se dosja e tenderit nuk është përgatitur në harmoni me legjislacionin në fuqi, pasi që janë vendosur kërkesa diskriminuese të cilat ju pamundësojnë ofertimin kompanive të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht favorizojnë kompani të caktuara.

Në lidhje me pretendimet tona ankimore sa i përket pajisjeve autoriteti kontraktues është arsyetuar se ka të drejtë dhe diskrecion të përcaktojë pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës dhe se, nëse arsyetohet nevoja për pajisjet për të cilat është pretenduar se nuk janë të lidhura me objektin e kontratës, mund të bëjë korrigjimin e tonazhit dhe karakteristikave të tyre. Në këtë kuptim, autoriteti kontraktues i referohet edhe vendimit të OSHP-së nr. 2026/0415.

Sqarojmë se, edhe në këtë rast pretendimi ynë nuk ka qenë se autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të përcaktojë pajisjet që konsideron të nevojshme, por se kërkesat konkrete të përcaktuara në Aneksin 7 nuk janë arsyetuar në raport me nevojat reale të kontratës, sidomos sa i përket numrit dhe kapacitetit të pajisjeve, si dhe kërkesës për atest.

Konkretisht, autoriteti kontraktues nuk ka sqaruar pse kërkohen dy makina ngjeshëse vibruese, pse kamioni kiper duhet të jetë minimum 7 ton, pse cisterna duhet të jetë minimum 15 ton, pse kërkohet damper minimum 5 ton, si dhe pse makineria hidraulike duhet të ketë peshë 450–500 kg. Po ashtu, nuk është dhënë arsyetim konkret se përse kërkesa për atest është e domosdoshme për pajisjet e kontestuara.

Për më tepër, vetë Paneli Shqyrtues ka konstatuar lidhur me damperin minimum 5 ton se duhet të vlerësohet lidhshmëria e tij me objektin e kontratës dhe, nëse konsiderohet i nevojshëm, tonazhi duhet të zbritet në një nivel të arsyeshëm. Po ashtu, për pajisjet tjera të kontestuara, Paneli ka kërkuar që autoriteti kontraktues gjatë korrigjimit të procedurës t'i përmbahet konstatimeve të ekspertizës.

Prandaj, sqarojmë se thjesht deklarimi se autoriteti kontraktues ka diskrecion për përcaktimin e pajisjeve nuk e adreson pretendimin tonë. Autoriteti kontraktues është i obliguar të arsyetojë nevojën për secilën kërkesë dhe të dëshmojë se kufizimet e vendosura janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet. Në mungesë të një arsytimi të tillë, kërkesat e kontestuara mbeten kufizuese dhe cenojnë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik.

AK-ja, pasi është detyruar nga OSHP-ja të heqë kërkesën për inxhinierin e infrastrukturës rrugore/transportit, në ndryshimet e fundit ka shtuar kërkesa të reja dhe diskriminuese për stafin inxhinierik.

Konkretisht, AK-ja ka shtuar kërkesën për certifikim për siguri dhe shëndet në punë për inxhinierin hidroteknik, inxhinierin e infrastrukturës apo konstruktiv, inxhinierin konstruktiv dhe inxhinierin e komunikacionit.

Përderisa këto kërkesa nuk kanë qenë të nevojshme në kërkesat fillestare të tenderit, shtrohet pyetja se përse janë bërë të nevojshme vetëm tani. AK-ja duhet të arsyetojë qartë nevojën dhe proporcionalitetin e këtyre kërkesave të reja, pasi ndryshimi i tyre pas ndërhyrjes së OSHP-së krijon dyshime të arsyeshme se këto kërkesa mund të kenë për qëllim kufizimin e konkurrencës ose favorizimin e një operatori ekonomik të caktuar.

Kërkojmë që këto kërkesa shtesë të largohen, pasi nuk kanë qenë pjesë e kërkesave fillestare dhe paraqesin kufizim të panevojshëm dhe diskriminues për operatorët ekonomikë.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar vendimin e panelit shqyrtues, prandaj kërkojmë nga OSHP që të analizoj në detaje dosjen e tenderit dhe të detyroj AK të bëj ndryshimin e kërkesave të cilat i kemi kontestuar.

AK-ja, më datë 05.08.2026 në ora 10:33, pas vendimit të OSHP-së, ka publikuar formularin standard për korrigjimin e gabimeve, ndërsa datën e hapjes së ofertave e ka caktuar më 11.08.2026. Pra, AK-ja ka lënë një afat shumë të shkurtër për dorëzimin e ofertave dhe për ushtrimin e të drejtës për kërkesë për rishqyrtim. Edhe pse ne e kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afatit, kjo mënyrë e veprimit nga AK-ja krijon pengesë të panevojshme për operatorët ekonomikë që duan të kundërshtojnë kërkesat e ndryshuara. Për këtë arsye, kërkojmë nga OSHP-ja që ta marrë parasysh këtë veprim të AK-së dhe të vlerësojë nëse afati i caktuar ka qenë i arsyeshëm dhe në përputhje me rregullat e prokurimit.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”*.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 17.7 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që *“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”*.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”*.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të OE **AS TERMO SH.P.K.**

DETYROHET autoriteti kontraktues të respektoj vendimin e OSHP-së **nr. 2026/0415**

NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përkrahja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*